



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.906/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić kryesues Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja për Goren – PG në Komunën e Dragashit, e paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.906/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja për Goren – PG në Komunën e Dragashit, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në Komunën e Dragashit në Vendvotimet 0503A/01R, 0503A/02R, 0503A/03R, 0503A/04R, 0503A/05R, 0503A/06D, 0503A / 02R, 02A/02A/050, 0501A /01R, 0501A/02D, 0501X/01R, 0501X /02D.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga subjekti politik Lëvizja për Goren – PG në Komunën e Dragashit me të cilën ka kërkuar rinumërimin e vendvotimeve 0503A/01R, 0503A/02R, 0503A/03R, 0503A/04R, 0503A/05R, 0503A/06D, 0503A / 02R, 02A/02A/050, 0501A /01R, 0501A/02D, 0501X/01R, 0501X /02D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se subjekti politik Lëvizja për Goren – PG në Komunën e Dragashit ka paraqitur apel me të cilën ka kërkuar rinumërimin e vendvotimeve të lartcekura.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete, qoftë formular apo deklaratë që do të dëshmonte se ka pasur parregullsi në këto vendvotime. Pritjet e

ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel, pa paraqitur ndonjë dëshmi lidhur me këto pretendime.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.906/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuesi e Panelit
Milena Đerić



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.